

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT
P.nr.188/11
7 shkurt 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut të Gjilanit në trupin gjykues të përbërë prej gjykatësit të EULEX-it Dariusz Sielicki si kryetar i trupit gjykues, dhe gjykatësve vendorë Afrim Shalës dhe Rasim Rasimit si anëtarë të trupit, të ndihmuar nga procesmbajtësi Joseph Hollerhead dhe Gjergj Zimaj si përkthyes, në lëndën penale kundër:

Besim Tahiri, gjithashtu i njohur si "Qeqeni, emri i babait Njazi, i lindur me 18 gusht 1980 në Vranje, Republika e Serbisë, jeton në fshatin Doberqan, komuna e Gjilanit, momentalisht në paraburgim që nga 24 shtatori 2011;

Njazi Tahiri, emri i babait Sabri, i lindur me 19 janar 1960 në Suharne, Republika e Serbisë, jeton në fshatin Doberqan, komuna e Gjilanit, në paraburgim që nga 29 prilli 2011 deri me 29 korrik 2011.

Të akuzuar sipas Aktakuzës PP Nr 106/11 me veprën penale *Detyrim (të kryer në bashkëveprim)* në shkelje të nenit 267 par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) të kryer me 29 prill 2011 në Gjilan,

Pas mbajtjes së seancave kryesore publike gjyqësore me 26 janar 2012 dhe 6 shkurt 2012, dhe pas votimit dhe këshillimit të trupit gjykues me 7 shkurt 2012, në bazë të nenit 391, paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me 7 shkurt 2012, sipas nenit 392 paragrafi (1) i KPPK-së shpall publikisht dhe në prani të palëve si në vijim:

AKTGJYKIM

Besim Tahiri dhe **Njazi Tahiri**

JANË FAJTOR

Për veprën penale *Detyrim të kryer në bashkëveprim* në shkelje të nenit 267 paragrafi (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së;

për shkak se me 29 prill në Gjilan, së bashku me qëllim të përfitimit pasuror të paligjshëm, ata kanë përdorur kërcënime serioze kur kanë kërkuar nga vëllezërit Qani dhe Shemsi Xhelili që t'ju paguajnë atyre një shumë prej 20.000€, në atë mënyrë që Besim Tahiri në vend parkimin afër bankës BKT i ka thënë Shemsi Xhelilit se përndryshe Shemsi Xhelili mund të harrojë Kosovën, punën e tij dhe familjen e tij dhe Njazi Tahiri i ka thënë Qani Xhelilit në zyrën e vëllezërve se pëndryshe do të bëhet keq për Qani Xhelilin dhe familjen e tij, dhe si rezultat i këtij veprimi Njazi Tahiri mori nga vëllezërit Qani dhe Shemsi Xhelili përfitim material në shumën prej 2000 Eurove dhe rrjedhimisht i pandehuri Nijazi Tahiri ishte arrestuar nga Policia e Kosovës.

për këtë arsye, nëpërmjet këtij aktgjykimi ata janë

DËNUAR:

Besim Tahiri me tri vite burgim për veprën penale *Detyrim të kryer në bashkëveprim* në shkelje të nenit 267 paragrafi (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së;

Njazi Tahiri me dy vite burgim për veprën penale *Detyrim të kryer në bashkëveprim* në shkelje të nenit 267 paragrafi (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së;

Me këtë aktgjykim paraburgimi i Besim Tahirit vazhdohet derisa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë pasi që ende ekziston rreziku i ikjes siç parashihet me nenin 281, par. 1 nënpar. 2 pika i). Koha e kaluar në paraburgim nga Besim Tahiri nga 24 shtator 2011 e këtej do të llogaritet në dënimin e shqiptuar sipas nenit 391 paragrafi (1) nënparagrafi 5 dhe neni 73, par.1 KPK;

Koha e kaluar në paraburgim nga Nijazi Tahiri nga 29 prilli 2011 deri me 29 korrik 2011 do të llogaritet në dënimin e shqiptuar sipas nenit 391 paragrafi (1) nënparagrafi 5 dhe neni 73, par.1 KPK;

Të akuzuarit do të paguajnë paushallin nga 30€ secili dhe do t'i kompensojnë shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 102, paragrafi 1 i KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve për përkthim. Një aktvendim i veçantë lidhur me shpenzimet do të lëshohet nga gjykata ku do të jepen ato informata sipas nenit 100 Paragrafi (2) i KPPK-së.

Palët e dëmtuara kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për ndonjë dëm material, nëse ka, në procedurë civile sipas nenit 112, par. 1 dhe 2 KPPK.

ARSYETIM

Historiati procedural

Aktakuza

Me 20 tetor 2011 Zyra e Prokurorisë Speciale paraqiti Aktakuzën PP.nr.106/11 kundër të akuzuarve Besim Tahirit dhe Nijazi Tahirit për veprën penale të Detyrimit të kryer në bashkëveprim në shkelje të nenit 267 par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës ("KPK") të kryer me 29 prill 2011 në Gjilan.

Me 9 nëntor 2011 gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit konfirmoi aktakuzën e përmendur më lart me aktvendimin KA.nr. 181/11

Gjatë seancës së konfirmimit të dy të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm.

Kompetenca e Gjykatës dhe Përbërja e Trupit gjykues

Të akuzuarit ishin akuzuar me një vepër të dënueshme me burgim prej një deri më dhjetë vite.

Në pajtim me nenin 23 (1) të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut kanë juridiksion të gjykojnë në veprat penale të shkallës së parë të dënueshme me burgim prej më së paku pesë vite apo ato vepra të dënueshme me burgim afatgjatë.

Vepra penale, sipas aktakuzës, ishte kryer në qytetin e Gjilanit e cila është në territorin e Qarkut të Gjilanit. Prandaj, në pajtim me nenin 27 (1) të KPPK-së, kjo gjykatë ka kompetencë territoriale të gjykojë lëndën.

Palët nuk kanë ngritur asnjë çështje lidhur me juridiksionin e kësaj gjykate, sidoqoftë çështja e kompetencës së gjyqtarëve të EULEX-it për të kryesuar në këtë çështje ishte kontestuar nga avokati mbrojtës i Besim Tahirit, Z. Haxhi Millaku.

Duhet të përmendet se në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve, Caktimin e Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (me tutje "LiJ"), gjykatësit e EULEX-it të emëruar në procedurat penale kanë juridiksionin dhe kompetencën lidhur me çfarëdo lënde të hetuar apo ndjekur nga Prokurorët Special të Republikës së Kosovës. Me 18 nëntor 2011 Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it vendosi se trupi gjykues në këtë lëndë duhet të përbëhet nga shumica e gjykatësve vendorë dhe caktoi Dariusz Sielickin si Kryetar të trupit gjykues. Aktvendimi ishte bazuar në nenin 3.7 të LiJ. Për këtë arsye, trupi gjykues ishte përbërë si duhet si një trup gjykues i përzier prej një gjykatësi të EULEX-it si kryetari i trupit gjykues dhe dy gjykatës vendorë.

Seanca kryesore

Seanca kryesore që ishte publike u mbajt me 26 janar dhe 6 shkurt 2012 në prani të Prokurorit Special Maarit Loimukoski, të akuzuarit Besim Tahirit dhe avokatit të tij mbrojtës Haxhi Millakut, të akuzuarit Njazi Tahiri dhe avokatit të tij mbrojtës Masar Morina. Me 26 janar të pranishëm në seancën kryesore ishin edhe palët e dëmtuara Qani Xhelili dhe Shemsi Xhelili dhe avokati i tyre **Halit Azemi**. As palët e dëmtuara e as përfaqësuesit e tyre të autorizuar nuk u shfaqën në seancën e radhës pa marrë parasysh faktin se ata ishin informuar në mënyrë të rregullt në fund të seancës së fundit për datën, kohën dhe vendin e vazhdimit.

Në pajtim me nenin 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtarë përkthyen në seanca dhe të gjitha dokumentet e gjykatës relevante për gjykim nga gjuha Angleze në gjuhën shqipe dhe vice-versa, sipas nevojës.

Përmbledhje dhe vlerësimi i dëshmime të paraqitura

Trupi gjykues bazoi gjetjet e tij faktike në dëshmitë vijuese të cilat u konstatuan të jenë plotësisht të besueshme: deklaratat e palëve të dëmtuara Qani Xhelilit dhe Shemsi Xhelilit të dhëna në gjykatë me 26 janar 2012, deklaratat e Lulzim Krasniqit dhe Ali Berishës të dhëna në gjykatë me 6 shkurt 2012 dhe përmbajtja e incizimit të videos së ofruar nga pala e dëmtuar Qani Xhelili e cila iu kishte paraqitur trupit gjykues dhe palëve me 6 shkurt.

Të dy vëllezërit Xhelili dhanë një përshkrim të detajuar dhe logjik të ngjarjeve. Ata cituan fjalë për fjalë kërcënime që iu kishin bërë atyre nga të dy të akuzuarit dhe përshkruajtën se si kishin reaguar ata në kërcënime. Trupi gjykues iu kushtoi vëmendje të gjitha ndryshimeve dhe mospërputhjeve në mes të versioneve të paraqitura nga vëllezërit Xhelili. Versioni më i qartë kishte të bëjë me shkëmbimin e informatave rreth kërcënimeve kjo do të thotë cila prej tyre e kishte inicuar bisedën telefonike në mes tyre lidhur me këtë çështje dhe në çfarë kohe. Kishte po ashtu mospërputhje në mes të përshkrimit të fakteve të lidhura drejtpërdrejt me dorëzimin e zarfit të paraqitur nga Qani Xhelili dhe të incizimit me video të këtij dorëzimi. Pas krahasimit të përpiktë reciprok të deklaratave të dy vëllezërve Xhelili dhe të gjitha pjesët e dëshmime tjera të cilat ishin vlerësuar si të besueshme trupi gjykues erdhi në përfundim se ndryshimet dhe mospërputhjet rezultojnë nga koha e kaluar dhe papërsosshmëria natyrale e kujtesës njerëzore. Në fakt këto ndryshime dhe mospërputhje sigurojnë trupin gjykues se dëshmitë ishin plotësisht spontane dhe nuk kanë qenë të përgatitura përpara nga dëshmitarët. Në elementet thelbësore të gjitha pjesët e dëshmime të përmendura më lart duke përfshirë edhe incizimin me video kanë vërtetuar dhe përforcuar plotësisht njëra tjetrën.

Nuk ka pasur asnjë dyshim lidhur me autencitetin e incizimit me video. Pjesët në vijim të pajisura me vulën kohore të futura në incizim ishin rikthyer në ekranet televizive me të cilat salla e gjykatës është e pajisur: 29 prill 2011: nga 15:36:13 deri 15:38:15, nga 16:00:04 deri 16:05:17, nga 16:45:21 deri 16:50:01, dhe 30 prill 2011 nga 00:13:17 deri 00:32:27. Autenciteti i saj ishte përcaktuar nga dëshmia e Qani Xhelilit i cili përshkroi si ajo ishte marrur dhe ruajtur. Për më shumë autenciteti nuk ishte kundërshtuar nga asnjëri prej të akuzuarve apo nga avokatët e tyre mbrojtës. Incizimi tregon një mashkull,

të identifikuar nga Qani Xhelili si Njazi Tahiri, i cili i afrohet lokaleve afariste të vëllezërve Xhelili me veturë dhe pastaj duke hyrë në zyrën e tyre. Incizimi gjithashtu shfaq një dorëzim të zarfit e cila sipas dëshmisë së vëllezërve Xhelili përmbante haraçin. Prapë, as identifikimi e as fakti se zarfi iu kishte dorëzuar Njazi Tahirit nuk ishte kontestuar nga mbrojtja.

Trupi gjykues gjithashtu konstatoi se dëshmitë e dy zyrtarëve të policisë së Kosovës, Ali Berishës dhe Lulzim Krasniqit, janë të sigurta dhe të besueshme. Ata paraqitën faktet në mënyrë logjike dhe spontane dhe nuk ka pasur asnjë element në materialin dëshmues, i cili ishte pranuar gjatë seancës që kundërshtonte versionet e tyre. E vetmja mospërputhje në mes të dëshmisë së Lulzim Krasniqit dhe dëshmisë së vëllezërve Xhelili ishte lidhur me shumën e parave në zarf dorëzuar tek Njazi Tahiri. Kjo mospërputhje duket të jetë një gabim që mund të sqarohet me veçoritë e kujtesës njerëzore dhe nuk e dëmton vlerësimin pozitiv të besueshmërisë së dëshmitarit të miratuar nga ky trup gjykues.

Trupi gjykues ka pranuar si dëshmi kallëzimin penal të 30 prillit 2011, të pajisur me numrin e lëndës 2011-CA-0749 sidoqoftë ai ka shërbyer vetëm si bazë për themelimin e faktit që vëllezërit Xhelili raportuan kërcënimet në polici dhe si ata kanë paraqitur ngjarjet në atë kohë. Një informatë e mbledhur nga një person prej personit tjetër lidhur me ndonjë ngjarje, kusht apo gjë për të cilën personi i parë nuk ka përvojë direkte kur është dorëzuar si dëshmi quhet si dëshmi thashetheme. KPPK nuk e ndalon në mënyrë eksplicite pranueshmërinë e dëshmisë thashetheme. Sidoqoftë sipas nenit 158, nëse ka të ngjarë se një person mund të jep informatë për një vepër penale, kryerësin dhe rrethanat e rëndësishme relevante për procedurat penale atëherë ai apo ajo duhet të ftohet si dëshmitar. Për këtë arsye është e qartë se KPPK i jep prioritet ekzaminimit të drejtpërdrejtë të burimit të informatave sesa përsëritjes që vjen nga një person tjetër, dhe është e qartë se një përsëritje e tillë nuk mund të jetë më bindëse sesa dëshmia e një dëshmitari burimor. Prandaj raporti ishte përdorur jo si bazë për gjetjen e faktit por më shumë për të vërtetuar besueshmërinë e palëve të dëmtuara. Trupi gjykues mendon se raporti nuk ka përmbajtur asnjë element që kundërshton dëshminë e tyre.

Për më shumë, në pajtim me nenin 375 të KPPK-së informatat për dënimet e mëparshme lidhur me të dy të akuzuarit ishin paraqitur gjatë seancës kryesore. Nuk ka pasur asnjë arsye për të kontestuar saktësinë e tij.

Trupi gjykues ka vlerësuar në mënyrë kritike deklaratën e Njazi Tahirit të dhënë në gjykatë me 6 shkurt 2012. I akuzuari pranoi se kishte shkuar disa herë tek zyra e Qani Xhelilit dhe kishte marrur një zarf nga ai dhe pretendoi se ai kishte arritur një marrëveshje për një kredi vullnetare me të pa përdorur asnjë kërcënim. Kur është ballafaquar me deklaratat e palëve të dëmtuara dhe sekuencat e videove të incizuara, këto pretendime nuk ishin fare bindëse. Kjo është kundër mendimit praktik për të besuar se një ndërmarrës i arsyeshëm do të huazonte në mënyrë vullnetare një shumë të tillë të parave debitorit pa asnjë burim të besueshëm dhe të verifikueshëm të hyrave siç ishte Njazi Tahiri. Poashtu nuk ka të ngjarë se një person që kërkon hua do të sillej në atë mënyrë të bezdisshme siç ishte demonstruar nga i akuzuari me fjalë të tjera duke ardhur shume herë tek kreditori dhe duke e thirrur atë vazhdimisht në telefon. I akuzuari nuk ka paraqitur asnjë arsye bindëse pse pala e dëmtuar do të pajtohej me një kërkesë të tillë të paarsyeshme.

I akuzuari Besim Tahiri vendosi që të mos deklarohet në seancën kryesore.

Rekonstrukcioni i fakteve

Faktet në vijim janë vendosur nga trupi gjykues si rezultat i vlerësimit të dëshmimeve më lart:

Vëllezërit Qani dhe Shemsi Xhelili udhëheqin një biznes me material ndërtimor me shumicë në Gjilan. Në mëngjesin e 29 prillit 2011 në mes të orës 11.00 dhe 13.00 Besim Tahiri iu afrua Shemsi Xhelilit në vend-parkimin afër lokaleve të bankës BKT në Gjilan. Ai e prezantoi vetveten si, "Komandant Qeqeni" dhe gjithashtu edhe me emrin dhe mbiemrin e tij të plotë kërkoi që Shemsi Xhelili t'i paguajë atij 20000 Euro brenda 2 orëve ose përndryshe ai mund të harrojë biznesin e tij, Kosovën dhe familjen e tij. Shemsi Xhelili nuk ka kthyer përgjigje dhe ai ka shkuar në bankë. Besim Tahiri u ul në veturë dhe e ndoqi Shemsi Xhelilin duke vozitur ngadalë derisa ai hyri në bankë. Pastaj Besim Tahiri u largua.

Pak minuta pas orës 15.00 Njazi Tahiri erdhi tek lokali afarist i Qani Xhelilit në Gjilan dhe kërkoi nga ai 20000 Euro. Në të njëjtën pasdite ai erdhi tek Qani Xhelili edhe tri herë me të njëjtën kërkesë. Ai gjithashtu e kontaktoi atë me telefon disa

herë dhe e përsëriti kërkesën. Ai i tha Qani Xhelilit se nëse dështon të paguajë do të jetë keq për të dhe familjen e tij.

Në mbrëmje vëllezërit Xhelili kontaktuan policinë. Gjersa ata flisnin me zyrtarët e policisë në stacionin policor Njazi Tahiri vazhdonte të thërriste Qani Xhelilin duke e përkujtuar atë për kërkesën. Qani Xhelili, duke vepruar në bashkëpunim me policinë, i tha atij se ai ishte duke i rregulluar paratë dhe e caktoi një takim rreth orës 24.00 në zyrën e tij. Të dy vëllezërit erdhën në zyrë. Njazi Tahiri erdhi atje dhe mori nga Qani Tahiri një zarf që mbante 2.000 Euro. Ai shkoi pa kontrolluar përmbajtjen e zarfit. Së shpejti pas kësaj ai u arrestua nga policia.

Në bazë të informatave nga regjistri penal:

Me aktgjykimin P.Nr. 199/2003, të datës 25 qershor 2004, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Gjilanit, Besim Tahiri ishte shpallur fajtor për tri pikë të rrëmbimit dhe ishte dënuar me një dënim unik prej 7 viteve burgim. Me aktgjykimin AP 470/2004, të datës 27 mars 2007, Gjykata Supreme e Kosovës konfirmoi këtë aktgjykim në lidhje me dy pikët të rrëmbimit. **Pika e tretë është duke e pritur ri-gjykimin dhe për këtë arsye as ai e as dënimi unik nuk janë ende të formës së prerë;**

Njazi Tahiri konsiderohet si të mos jetë dënuar për veprë penale.

Klasifikimi ligjor i veprimit të akuzuarit

Edhe pse gjetja e trupit gjykues konfirmon faktet të paraqitura në aktakuzë, klasifikimi ligjor i veprimeve të akuzuarit të aplikuar nga trupi gjykues ndryshon nga ai i paraqitur nga prokuroria për shkak se nuk është dëshmuar se i akuzuari ka marrur apo se ka tentuar të përfitojë përfitim të madh material.

Veprimet e kryera nga Njazi Tahiri dhe Besim Tahiri përbëjnë një veprë penale të rrëmbimit e cila është e përcaktuar në nenin 267 paragrafin 1 të KPK-së. Ata të dy kanë përdorur kërcënim serioz në mënyrë që të shtrëngojnë vëllezërit Xhelili të paguajnë haraç në dëm të pasurisë së tyre. Kërcënimi i bërë nga ata duhet të konsiderohet serioz jo vetëm për shkak të reagimit të palëve të dëmtuara por gjithashtu në mënyrë të përgjithshme, që do të thotë nga perspektiva e çfarëdo vëzhguesi të arsyeshëm. Autorët e krimit përmendin pasojat pa thënë se si ajo do të arrihet. Besim Tahiri i tha Shemsi Xhelilit se Shemsi Xhelili mund të

harrojë Kosovën, punën e tij dhe familjen e tij dhe Njazi Tahiri i tha Qani Xhelilit se do të jetë keq për Qani Xhelilin dhe familjen e tij. Nuk ka asnjë dyshim se këto pasoja referohen si rrezik substancial dhe dëm palëve të dëmtuara apo familjeve të tyre. Ka mundësi që kërcënimet të kryheshin në mënyra të ndryshme pasi që të dy autorët e krimit janë fizikisht dhe mentalisht të aftë për të dhe nuk ka asnjë indikacion se ata nuk janë në gjendje të bëjnë atë.

Duhet të supozohet deri në nivelin e sigurt se të dy të akuzuarit vepruan në bashkëpunim. Edhe pse ata kurrë nuk vepruan së bashku në të njëjtin vend dhe kohë veprimet e tyre ishin qartazi të koordinuara në kohë dhe gjithashtu edhe në përmbajtjen e kërkesave të tyre të paligjshme. Nuk mund të ketë asnjë sqarim tjetër të këtij sinkronizimi dhe ngjashmërie të veprimeve të tyre përpos për të konkluduar se ata kanë ekzekutuar një plan të pranueshëm së bashku dhe si pasojë ata kanë kryer krimin i cili është një thelb i bashkë-kryerjes të përshkruar në nenin 23 të KPK-së.

As shuma të cilën të akuzuarit e morën nga vëllezërit Xhelili e as shuma e cila ishte kërkuar e arriti pragun e "dobisë së madhe materiale" të shënuar me nenin 267 paragrafi 2 i paraqitur nga prokuroria si klasifikim ligjor i krimit në dorë. Nuk ka as interpretim autentik e as jurisprudence që drejtpërdrejt e sqaron këtë element të krimit. Sidoqoftë trupi gjykues aplikoi interpretimin *mutatis mutandi* të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin e datës 21 tetor 2010 lidhur me shprehjen "dëm i madh material" e përdorur në formulimin e KPK-së e cila ishte definuar si një vlerë që e tejkalon shumën prej 20000 Eurove.

Prandaj, trupi gjykues erdhi në përfundim se vepra penale e kryer nga të akuzuarit duhet të klasifikohet si vepër penale e Rrëmbimit të kryer në bashkë-veprim në shkelje të nenit 267 Paragrafi (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

Përcaktimi i dënimit

Gjatë përcaktimit të dënimit për secilin të akuzuar gjykata ka qenë e obliguar të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas nenit 64 Paragrafi (1) i KPK-së.

Lidhur me të dy të akuzuarit trupi gjykues mori parasysh faktorët rëndues si në vijim:

Detyrimi në Kosovë duket të jetë një krim i kryer shpesh në këto kohë. Ai seriozisht dëmton ose bile edhe ndalon zhvillimin e ndërmarrësisë në Kosovë; prandaj dënimi për këtë lloj të krimit duhet t'i shërbejë si një preventivë e përgjithshme për të gjithë autorët potencial të krimit.

Të akuzuarit kanë vepruar haptas, në mënyrë flagrante, me guxim, dhe prandaj kanë shfaqur një mospërfillje të madhe për mundësinë e ekspozimit në zbatim të ligjit që tregon se niveli i tyre për respektimin e ligjit është i ulët.

Ata të dy nuk kanë një profesion të përhershëm, i cili do t'iu shërbente si burim i të hyrave, dhe që duhet të shihet si faktor që do t'i bëjë ata të prirur të mos i binden ligjit në të ardhmen.

Lidhur me Njazi Tahirin trupi gjykues mori parasysh si një faktor rëndues këmbëngulësinë e tij në kryerjen e veprës penale e cila është manifestuar në morinë e vizitave të tij tek Qani Xhelili dhe thirrjeve telefonike të bëra.

Lidhur me Besim Tahirin trupi gjykues u fokusua gjithashtu në dënimet e tij të mëhershme të dy pikëve të rrëmbimit të cilat tanimë janë të formës së prerë (aktgjykimi P.Nr. 199/2003, i datës 25 qershor 2004, i lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Gjilanit, aktgjykimi AP 470/2004, i datës 27 mars 2007 i Gjykatës Supreme të Kosovës) dhe në këtë aspekt mund të bëhet një konkludim i qartë se dënimi nuk ka rezultuar në parandalimin e tij nga ri-kryerja e veprave.

Si faktor lehtësues trupi gjykues mori parasysh se:

Veprat penale të kryera nga të akuzuarit nuk kanë rezultuar në dëm të madh dhe të përhershëm për palët e dëmtuara;

Modus operandi i tyre nuk ka qenë fare i sofistikuar dhe duhet të shihet si primitiv dhe në fakt ka qenë i lehtë për t'u mbrojtur nga ai.

Për më shumë në lidhje me Njazi Tahirin trupi gjykues mori parasysh se ai është mbajtës i familjes dhe ai gjithashtu posedon një fermë. Pa marrë parasysh faktin se ai nuk merr asnjë të ardhur nga ajo, kjo çon në përfundim se ka lidhje shoqërore dhe ekonomike të cilat duhet ta parandalojnë të kryejnë krim në të ardhmen.

Ishte detyra e gjykatës të llogaris periudhën kohore që i akuzuari ka kaluar në paraburgim në afatin e burgimit e cila ishte vënë përkatësisht për secilin.

Shpenzimet

Pasi që të dy Njazi Tahiri dhe Besim Tahiri janë shpallur fajtor sipas nenit 102, paragrafi 1 i KPPK-së ata do të paguajnë një shumë paushallë në shumën prej 30 EUR secili, dhe do të kompensojnë shumën e procedurës penale me përjashtim të shumës së përkthimit.

Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të lëshohet nga gjykata kur do të merret informata e tillë sipas nenit 100 Paragrafi (2) i KPPK-së.



Kryetari i trupit gjykues

Dariusz Sielicki

Anëtari i trupit gjykues

Anëtari i trupit gjykues

Rasim Rasimi



Afrim Shala

Procembajtësi

Joseph Hollerhead

MJETI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi personat e autorizuar munden të paraqesin ankesë në formë të shkruar nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Gjiçanit brenda pesëmbëdhjetë dita nga data kur është pranuar kopja e këtij aktgjykimi.